Outlook

**Re: Kthim përgjigje mbi hapësirat e destinuara për plazhe në territorin e Bashkisë Sarandë**

**From** Info <info@bashkiasarande.gov.al>
**Date** Wed 9/2/2026 1:37 PM
**T**[redacted]
**Cc** info@idp.al <info@idp.al>

Përshëndetje,

Në lidhje me informacionin e kërkuar, ju bëjmë me dije se plazhet e Ksamilit janë pjesë e territorit administrativ të Bashkisë Sarandë dhe administrohen nga kjo bashki, në përputhje me legjislacionin dhe aktet nënligjore në fuqi.

Lidhur me sipërfaqet e plazheve, ju sqarojmë se në informacionin e përcjellë nga Bashkia Sarandë është paraqitur **sipërfaqja e përgjithshme e plazheve**, pasi aktualisht sipërfaqet nuk janë të ndara në mënyrë të veçantë sipas njësive administrative, përkatësisht sa i përket Ksamilit dhe sa Sarandës.

Në total, sipërfaqja e plazheve përbëhet nga rreth 30% sipërfaqe e destinuar për plazh publik dhe 70% sipërfaqe e dhënë për ushtrimin e aktivitetit nga subjektet private, nëpërmjet procedurave dhe kontratave përkatëse.

Bashkia Sarandë administron dhe menaxhon hapësirat e plazheve të Ksamilit në përputhje me legjislacionin në fuqi, aktet nënligjore dhe rregulloret përkatëse, duke respektuar rregullat për përdorimin e hapësirave publike, organizimin dhe funksionimin e stacioneve të plazhit, garantimin e aksesit të publikut, si dhe kërkesat për mbarëvajtjen e sezonit turistik.

Sipas Udhëzimit te përbashkët,së Ministrisë të Punëve të Brendshme, Ministrit të Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Ministrit të Mjedisit, “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 2, datë 15.11.2023 ‘Për nivelin kufi të zhurmës për një mjedis të dhënë dhe për fushën e veprimtarive ekonomike-shoqërore’”. me anë të të cilit janë përcaktuar oraret e lejuara për zhvillimin e aktiviteteve me muzikë në subjektet që ushtrojnë aktivitet në territorin e Bashkisë Sarandë. Sipas këtij urdhezimi ora e lejuar për muzikë është deri në orën 24:00.

Për sa më sipër, Bashkia Sarandë vijon të monitorojë administrimin dhe përdorimin e hapësirave të plazheve, me qëllim respektimin e rregullave të përcaktuara dhe garantimin e një bashkëjetese sa më të mirë ndërmjet veprimtarisë turistike, interesit publik si dhe të drejtave të qytetarëve.

Me respekt, Bashkia Sarandë